



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 48/2012
Prishtinë, më 07.02. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Krasniqi – AKK, Ukë Gashi - ZRPK dhe Florije Mehmeti –KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe konsulentja e Komisionit - Brikena Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 31.01.2012;
3. Shqyrtimi i Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
5. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 31. 01.2012

Procesverbali i mbledhjes së 31. 01.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës ka punuar grupi i punës, që ka mbajtur disa takime dhe ka shqyrtuar Projektstatutin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Kryesuese e grupit të punës ka qenë znj. Sala Berisha-Shala të cilën e ftoi ta paraqiste raportin.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se grupi i punës ka mbajtur tri takime, në të cilat e ka shqyrtuar një pjesë të Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Tha se gjatë punës kanë hasur në disa vështirësi për shkak të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, sepse në disa nene ka mospërputhje. Në si grup i punës jemi munduar ta gjejmë një balancim midis Ligjit në fjalë dhe Projektstatutit që e kemi shqyrtuar deri te neni 12. Në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, te nenet 24 dhe 30, që i referohen njëra-tjetrës, po krijohen vështirësi në interpretimin se si do të duhet të jetë funksional ky Statut. Propozoj të mundësohet që edhe një herë të mblidhet grupi i punës për ta shqyrtuar në hollësi Projektstatutin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe kërkoj që për të hapet debat i gjerë në Komision. Kërkoj që anëtarët e Komisionit të marrin pjesë në mbledhjet e grupit të punës për ta dhënë kontributin e tyre.

Ahmet Krasniqi (Autoriteti Kosovar i Konkurrencës) - Tha se Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duhet të jetë sa më i qartë, sepse Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është person juridik që e rregullon edhe Ligji për mbrojtjen e konkurrencës. Problemi ka lindur se në Statut thuhet se kryetari i Komisionit të AKK-së të mos udhëheq më stafin e administratës. Propozoj që kjo kompetencë t'i mbetet kryetarit të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, i cili pastaj duhet t'ia delegojë kompetencat drejtorit ekzekutiv. Theksoi se kjo çështje trajtohet me ligj të posaçëm që i rregullon kompetencat e AKK-së dhe se mbi këtë bazë është hartuar Projektstatuti.

Lutfi Zharku – Tha se disa agjenci dhe borde në vendin tonë janë politike. Stafi trajtohet me Ligjin për shërbyesit civilë dhe funksionimi i tij duhet të rregullohet si trup i përbashkët. Për Statutin, tha se disa çështje që janë në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës nuk kanë nevojë të përshkruhen edhe në Statutin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, sepse janë të panevojshme dhe e vështirësojnë funksionimin normal të Autoritetit.

Visar Ymeri – Tha se grupi i punës, gjatë shqyrtimit të Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, sa i përket çështjes se kush prej Autoritetit duhet të menaxhojë me stafin e administratës dhe kompetencë e kujt të mbetet me Statut mbikëqyrja e stafit të administratës, kryetarit të Bordit apo drejtorit ekzekutiv, ka hasur në vështirësi. Në bazë të Ligjit për shërbyesit civilë ose të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës duhen të zhvillohen procedurat për punësimin e stafit mbështes administrativ të Autoritetit. Çështja e dytë, që e ka diskutuar grupi i punës, që ka mbetur e hapur dhe ka zgjatur më shumë, është emërtimi i sekretarit të përgjithshme apo i drejtorit ekzekutiv. Në bazë të cilave kompetenca duhet të zgjidhet emërtimi.

Kryetari – Meqë anëtarët e Komisionit u informuan nga grupi i punës, për punën e tyre dhe për vështirësitë që kanë hasur gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, kërkoj që grupi i punës të mbledhet përsëri që t’i shqyrtojë dhe një herë çështjet, që kanë mbetur të hapura në Projektstatutin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe pastaj t’ia dorëzojë Komisionit raportin me rekomandime.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryetari - Kërkoj që për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës të formohet një grup i punës për ta mbikëqyrur sa po zbatohet ky Ligj dhe për t’i parë pengesat më të cilat mund të përballen institucionet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit në fjalë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;*
2. *Grupi i punës ka këtë përbërje: Lutfi Zharku - raportues, Zenun Pajaziti, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala dhe Visar Ymeri - anëtarë;*
3. *Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit, mund t’i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;*
4. *Grupi i punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit ta hartojë Planin e veprimit dhe ta përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe për miratim në Komision.*

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

Myzejene Selmani - Kërkoj që në një mbledhje të radhës të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të na njoftojë lidhur me privatizimin e Distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Komisioni përkrahu propozimin e deputetes Selmani që në një nga mbledhjet e ardhme të ftohet ministri Beqaj të raportojë për çështjen e privatizimit të Distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit